

Pyetje të Shtruara Shpesh/Frequently Asked Questions (FAQ)		
Nr.	PYETJE	PËRGJIGJE - PROGRAMI IPARD II, Thirrja II
1	Çfarë është IPARD-i?	Instrumenti i Ndhmës së Para-Aderimit (IPA II) 2014 - 2020 është mjeti kryesor i përdorur nga Bashkimi Evropian (BE) për të ofruar mbështetje financiare dhe teknike për vendet e zgjerimit. Objektivi i përgjithshëm i IPA-s për Shqipërinë është të mbështesë reformat dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për të arritur pajtueshmërinë me ligjet e BE-së, për të përgatitur plotësisht vendin për të marrë detyrimet e anëtarësimit në BE. IPA ka një fushë të Politikave të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (IPARD II), me objektivi ofrimin e asistencës për vendet kandidatë të BE-së për zbatimin e programeve shumëveçore, që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe zonave rurale, dhe në përgatitjen e tyre për zbatimin e politikave të BE-së.
2	Cilat janë masat për të cilat jepet mbështetje nga IPARD?	Programi IPARD II ka tre masa për të cilat mund të aplikohet: Masa 1: "Investime në asetet fizike në ferma bujqësore" Masa 3: "Investime në asetet fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit" Masa 7: "Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Biznesit"
3	Mund të aplikoj më shumë se dy investime të ndryshme?	Brenda të njëjtës masë është e lejuar vetëm një aplikim, i cili mund të përfshijë më shumë se një sektor. Në rast se bëhet fjalë për dy masa të ndryshme, lejohet, por aplikanti duhet të sjellë dy aplikime të ndryshme, të cilat nuk kanë varësi funksionaliteti njëra nga tjetra.
4	Kur aplikohet për IPARD?	Për Thirrjen e Dytë afati për dorëzimin e aplikimeve është nga data 30.10.2019 deri më 16.12.2019. Çdo aplikim i mbërritur pas kësaj date, do të refuzohet.
5	Si aplikohet?	Aplikohet me zarf të mbyllur të dorëzuar brenda afateve përkatëse të aplikimit, pranë AZHBR, me postë ose dorazi. Për sigurinë tuaj, këshillojmë dorëzimin dorazi të aplikimit në adresën Rr. Muhamet Gjolleha, Nr. 56. Tiranë
6	Amund të aplikoj me NIPT -in e fermerit?	Përfutjes nga masat e Programit IPARD II janë personat fizikë, subjektet ose kooperativa që janë të regjistruara në QKB për aktivitetin që aplikojnë. Në varësi të Masës dhe investimit, kriteret e përgjithshme përcaktojnë marrësit e mbështetjes, sipas statusit juridik.
7	A është i detyrueshëm dokumenti nga Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor kur je person juridik?	Vërtetimi nga AREB duhet të dorëzohet për Masat 1. Për masën 7 vetëm në rast se po planifikoni investime në fermë, që i përkasin masës 7.
8	Unë sapo kam bërë një investim në bujqësi, a mund të përfitoj?	Sipas programit IPARD II investimet mund të fillojnë vetëm pas firmosjes së kontratës së mbështetjes financiare me AZHBR. Asnjë investim i kryer para kontraktimit nuk mund të financiohet.
9	Unë mora mbështetje nga Skema Kombëtare. A mund të aplikoj në IPARD?	Po, ju mund të aplikoni, por mbështetja nuk mund të jepet për investime të financuara një herë nga çfarëdo skemë mbështetjeje me fonde publike.
10	Çfarë dokumentash më duhen dhe kush mund të përgatisë dosjen e aplikimit?	1. Aplikimin mund ta përgatisni ju vetë. Informacionin mbi dokumentat që ju nevojiten, investimet e lejuara dhe masat e mbështetjes e gjeni në linkun http://azhbr.gov.al/programi-ipard-ii-thirrja-2-per-aplikime/ 2. Shoqëri konsulence private ofrojnë shërbime të mbështetjes së fermerëve në përgatitjen e dosjeve të aplikimit. 3. Për informacione shtesë mund t'i drejtoheni AZHBR në numrin e tel: 0800 83 83 dhe adresën e email: info@azhbr.gov.al
11	Ku mund të adresohemi për sqarime mbi programin apo kriteret e pranueshmërisë për investimet në masat 1, 3, 7.	Ju duhet të adresoheni vetëm në AZHBR. Adresa: Muhamet Gjolleha, nr. 56, Tiranë, dhe pranë Autoritetit Menaxhues pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr.2 , 1001, Tiranë, Shqipëri, Tel: + 355 4 2226551
12	Si bëhet pagesa e grantit?	Granti paguhet në një këst pas përfundimit të investimit (projektit) dhe pagesës së shpenzimeve të investimit nga përfutjesi.
13	Deri në sa lekë mund të përfitoj me një aplikim?	Për çdo masë ka një minimum dhe maksimum të shpenzimeve të pranueshme dhe rrjedhimisht edhe granti është i lidhur në varësi të këtyre shpenzimeve. Informacion më të detajuar do të gjeni në "Udhëzuesin për Aplikantët", i cili është i disponueshëm në linkun http://azhbr.gov.al/programi-ipard-ii-thirrja-2-per-aplikime/
14	Sa afat do të kem në dispozicion për realizimin e investimit?	Periudha e zbatimit të investimit (projektit) të planifikuar do të përcaktohet në kontratat individuale për dhënien e granteve ndërmjet AZHBR dhe përfutjesve dhe në varësi të tipit të investimit që do të kryhet.
15	A duhet të përmbush ndonjë standard të caktuar për të përfituar grant?	Në çdo investim është e detyrueshme përmbushja e standardeve minimale kombëtare dhe standardeve të BE-së, sipas masave dhe sektorëve përkatës. "Udhëzuesi për Aplikantët" dhe Formulari i Aplikimit, do t'ju ndihmojë për të kuptuar trupën teknike dhe standartet përkatëse që duhet të plotësoni.
16	Për çfarë investimi mund të aplikoj ?	Investimet duhet të jenë në përputhje me masën dhe sektorin përkatës. Njëkohësisht investimet e pranueshme duhet të jenë në përputhje me Aneksin 6 - Lista e Shpenzimeve të Pranueshme, ku jepen detaje se për cilat shpenzime mund të aplikoni. Aneksi 6 gjendet në linkun http://azhbr.gov.al/programi-ipard-ii-thirrja-2-per-aplikime/
17	Mund të jetë aplikant një person në moshë pensioni?	Programi IPARD II nuk ka si kriter kufizimin e moshës.
18	Për rastet e investimeve të mbjelljeve të reja nevojitet deklaratë mjedisore?	Po kërkohet. Çdo projekt duhet të analizohet në lidhje me standardet kombëtare dhe ato europiane, sipas rastit. Nëse investimi/legjislatiioni kërkon, ose jo plotësimin e standardeve janë Trupat Teknike, të cilët do ta konfirmojnë. Para dorëzimit të aplikimit në Agjencinë IPARD, çdo projekt duhet të analizohet në lidhje me standardet minimale kombëtare, që do të arrihen nga ndërmarrja në fund të investimit.

19	A mund të ketë pak më shumë informacion qoftë edhe orientues në lidhje me investimet e lejueshme në sektorin e mbarëshimit të kërmillit?	Për investimet e lejueshme ju duhet të konsultoheni me ANEKSIN 6 - Lista e Shpenzimeve të Pranueshme. Në këtë dokument janë të listuara sipas masave dhe sektorëve të gjitha shpenzimet, të cilat konsiderohen të pranueshme në programin IPARD II.
20	A mund të aplikohet me tokën shtet të marrë me qera?	Një nga kriteret për të përfituar nga programi IPARD II është se aplikanti duhet të provojë pronësinë mbi tokën/ndërtesën ose ndërtesat e lidhura me investimin, ose të drejtën e përdorimit me afat, të paktën 10 vjet që nga data e dorëzimit të aplikimit. Dokumentacioni që e përmbush këtë kriter është: - Fotokopje e certifikatës së pronësisë, e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme mbi tokën dhe ndërtesën (at), ku do të kryhet investimi, shoqëruar nga harta treguese, kartela e pasurisë dhe planimetria (skica), ose - Fotokopje e vërtetimit të pronësisë lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme mbi tokën dhe ndërtesën (at) ku do të kryhet investimi shoqëruar nga harta treguese, kartela e pasurisë dhe planimetria (skica), ose - Fotokopje e kontratës së qirasë/kontrata e huapërdorjes/kontrata e përdorimit me një afat të paktën 10 vjeçar pas datës së aplikimit, e noterizuar dhe - Fotokopje e Certifikatës së Pronësisë e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme mbi tokën dhe ndërtesa (at) të personave, të cilët kanë lëshuar me qera tokën dhe ndërtesën (at), e shoqëruar nga harta treguese, kartela e pasurisë dhe planimetria (skica) e titullit të rregjistruar të pronësisë.
21	Masa 7 "Investime ne Agroturizem", mund të aplikoj si start-up me statusin SHBB? Si do të vlerësohet efektiviteti i tyre?	Po mund të aplikoni dhe në këtë rast aplikanti duhet të paraqesë një Projekt Propozim Teknik, ose Plan Biznesi, që vërteton rentabilitetin ekonomik në përfundim të realizimit të investimit, si dhe duhet të konsultoheni me Anexin 6 për shpenzimet e pranueshme.
22	A mund të aplikojë një kompani, e cila prodhon ushqim për kafshët në Masën 7, në sektorin e Akuakulturës për prodhimin e ushqimit të peshqve?	Qëllimi i sektorit është krijimi i fermave të reja, ose zgjerimi i kapaciteteve prodhuese të fermave ekzistuese të Akuakulturës. Në këtë kontekst programi IPARD II mbështet investime, sipas ANEKSIT 6 - Lista e Shpenzimeve të Pranueshme, të cilat janë/do të zhvillohen në ferma ekzistuese të Akuakulturës. Pra investimet të cilat janë/do të zhvillohen jashtë fermave të Akuakulturës nuk janë të pranueshme.
23	Cili është dokumentacioni i pronësisë i pranuar për programin?	Dokumentacioni i kërkuar për pronësinë është sipas rastit dhe mund të jetë: A. Fotokopja e Certifikatës së Pronësisë të lëshuar nga Zyra për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme, të shoqëruar me hartën indikative dhe planimetrinë që tregon pronësinë e tokës dhe ndërtesës në të cilën do të kryhet investimi. B. Fotokopje e Vërtetimit të Pronësisë të lëshuar nga Zyra për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme të shoqëruar me hartën treguese, kartelën e pasurisë dhe planimetrinë ku thuhet pronësia e tokës dhe ndërtesës në të cilën do të kryhet investimi, ose fotokopje e noterizuar e kontratës së qirasë me një kohëzgjatje minimale të paktën 10 vjet pas datës së aplikimit me verifikim notarial. C. Fotokopje e Vërtetimit të Pronësisë të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme shoqëruar me hartën treguese, kartelën e pasurisë dhe planimetrinë e regjistruar të tokës, ku thuhet pronësia e tokës dhe e ndërtesës për personin që e ka marrë me qera.
24	Start-ups a lejohen në IPARD II?	Nuk ndalohet aplikimi i start-up, për sa kohë që përmbushen të gjitha kërkesat dhe kriteret e programit.
25	Nëse aplikanti nuk ka eksperiencë në fushën e bujqësisë 3 vjet, si bëhet i mundur aplikimi në masën 1 ?	Në këtë rast ju duhet të dorëzoni: -Vërtetim original lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, që vërteton se ka tre vjet eksperiencë pune në fushën e bujqësisë për investimin që kryen, ose - deklaratë që aplikanti merr përsipër që të ndjekë një trajnim profesional prej 50 orësh trajnim në sektorin përkatës përpara pagesës finale.
26	Nëse aplikon si SHBB kush është përfituesi i investimit nga IPARD II, anëtarët apo vetë SHBB?	Nëse aplikon si SHBB përfituesi është vetë SHBB, sipas aplikimit të bërë.
27	Nëse kam blerë traktor, apo mjete mekanike nga programe të tjera përfshirë dhe IPARD-like, a mund të aplikoj edhe në IPARD II?	Po mund të aplikohet në IPARD II. Në rast se aplikohet për të njëjtin lloj investimi duhet të jetë i mirë argumentuar pse lind nevoja për rinovim.
28	Mund të aplikoj sërish për një investim, nëse kam përfituar edhe nga thirrja e parë, Programi IPARD II?	Ju nuk mund të paraqesin një aplikim të ri në masën për të cilën keni përfituar, përpara marrjes së pagesës përfundimtare në bazën e një kontrate granti të mëparshme të kësaj mase.
29	Kush janë ekspertët tek të cilët duhet të drejtohem për të bërë dokumentacionin e kërkuar?	Sherbimet e Ekstensionit janë shërbime publike pa pagesë si dhe Ekspertë të ndryshëm të sektorit privat, të cilët ofrojnë këtë shërbim. Shpenzimet për ekspertizë në përgatitje dokumentacioni janë të lejuara, sipas përcaktimeve të shpenzimeve të lejuara në Anexin 6.
30	Nëse kemi përfituar nga skemat kombëtare, a mund të aplikojmë dhe në programin IPARD II?	Mund të aplikohet, por jo për të njëjtin investim.
31	Investimi që do të bëjmë duhet të përballohet nga investitori dhe pastaj e marrim rimbursimin?	Pas lidhjes së kontratës, investimi kryhet 100% me fondet e aplikantit, në respektim të kushteve kontraktuale, bazuar në kërkesën për pagesë, pas përfundimit të investimit bëhet pagesa e grantit.
32	Domosdoshmërisht duhen 3 oferta për realizimin e investimeve, apo blerjen e pajisjeve?	Për të gjithë zërat e shpenzimeve të pranueshme kërkohen tre (3) oferta nga ofrues të pavarur që pasqyrojnë një kërkim real dhe të pavarur të çmimeve të tregut.
33	Sa aplikime lejohen brenda një mase?	Brenda një mase lejohet vetëm një aplikim për subjekt.

34	Tek Masa 7, a është i pranueshëm investimi për një restorant, apo duhet shoqëruar me investime të tjera, dhe a duhet të jetë afër me fermën?	Për çdo investim të propozuar ju duhet që t'i referoheni Listës së Shpenzimeve të Pranueshme - Aneksit 6, dhe në varësi të sektorit që ju do të aplikoni do të gjeni edhe investimet e pranueshme.
35	Intensiteti i ndihmës për Masën 1 shkon nga 60% në 65%, dhe 70%. Për të shkuar tek 70% duhen përbushur kushtet edhe fermeri i ri, edhe zona malore?	Norma bazë e përfitimit nga Masa 1 është 60% , për Fermerët e Rinj është 65% dhe për Zonat malore 70% .
36	Nëse marr kredi, a do të më subvencionojë AZHBR për shpenzime që lidhen me kostot bankare?	Jo, tarifat bankare, kostot e garancive dhe detyrime të tjera të ngjashme janë shpenzime të pa pranueshme në programin IPARD II.
37	Në rastin e paraqitjes së ofertave, kur një kompani furnizon edhe tek pikat me pakicë mjetet bujqësore, a është e vlefshme oferta nëse merr edhe tek këto pika, edhe tek kompania kryesore?	Paraqitja e ofertave jo-reale, ose nga shoqëri jo të pavarura sjell refuzimin e aplikimit.
38	Lidhur me ujitjen me pika, kërkohet leje shfrytëzimi edhe leje përdorimi. Cilat janë institucionet që i japin këto leje?	Për lejen e shfrytëzimit dhe përdorimit të ujit duhet t'i referoheni Ligjit Nr. 111/2012 PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE.
39	Sasia prej 200 hl duhet të jetë e prodhuar, apo e shitur tek Masa 3 për sektorin e verës?	Kapaciteti i prodhimit duhet të jetë jo më pak se 200 hl.
40	A do ketë subvencionim për krerë?	Subvencionimet për krerë nuk janë të pranueshme në programin IPARD II.
41	Përsa i përket llogaritjes së nivelit të xhiros, që tek Masa 3 dhe 7 janë kritere skuatifikuese (përkatesisht 12 mln euro tek Masa 3, dhe 2.4 mln euro tek Masa 7), ka dhe një deklaratë që kërkohet në lidhje me shoqëritë partnere, ose të lidhura. Kjo llogarit edhe kompanitë që mund të jenë jashtë Shqipërisë, apo vetëm brenda territorit të Shqipërisë?	Në përllogaritjen e kufijve të përmasave të shoqërisë janë të përfshira të gjitha kompanitë partnere, dhe të lidhura brenda dhe jashtë vendit, sipas Aneksit 4 te Programit IPARD II. Përkufizimi i shoqërive partnere dhe të lidhura përcaktohet nga legjislacioni i BE-së: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:32003H0361
42	A mund të aplikojë një shtetas i huaj, apo duhet të jetë domosdoshmërisht shtetas shqiptar?	Investimi duhet të jetë në Shqipëri, dhe aplikanti duhet të jetë i regjistruar në QKB.
43	Sa duhet të llogaritet kursi i këmbimit për pajisje të blera jashtë Shqipërisë?	Llogaritja e kursit të këmbimit do të bëhet, sipas kursit të Komisionit Europian, duke marrë si bazë kursin e muajit pararendës para hapjes së thirrjes për aplikime (Kursi i këmbimit 121,26) Informacioni gjendet në faqen: http://ec.europa.eu/budget/contracts_grants/info_contracts/infoeuro/index_en.cfm
44	Ju lutem, mund të na konfirmoni nëse në Programin IPARD II janë të pranueshme mjetet bujqësore (Traktorë), që kanë si vend origjine Amerikën (USA), për investime që nuk e kalojnë vlerën 100 000 euro?	Për origjinën e vendeve të pranueshme për pajisjet e blera, ju lutemi të lexoni me kujdes kapitullin 5. Rregullat për shpenzimet e pranueshme në "Udhëzimin për Aplikantët", si dhe ANEKSIN 9: Lista e Vendeve të Pranueshme të Origjinës. Për investimet nën 100,000 EUR, nuk kërkohet origjina, por duhet të sigurohet përbushja e standarteve përkatëse kombëtare dhe të BE , sipas masës dhe sektorit.
45	Vërtetimi për pagesën e sigurimeve shoqërore për sa kohë para momentit të aplikimit nevojitet (për vitin kur bëhet aplikimi apo për 3 vitet e fundit)? Po në rastin kur fermeri është start-up?	Duhet Vërtetimi Original që provon se aplikanti ka përbushur detyrimet e pagesës së taksave (kontributet shoqërore, shëndetësore, lëshuar nga Zyra e Tatim Taksave për personat fizike dhe juridike, ose nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për fermerët individualë, jo më herët se 30 ditë përpara dorëzimit të aplikimit. Vërtetimi duhet të dorëzohet edhe për fermerët/ persona fizikë ose juridikë, të cilët janë start-up.
46	A janë të pranueshme investimet në thertore, dhe cilat janë kriteret e përfitimit?	Mbështetja do të jepet për ndërtimin e jo më shumë se dy thertoreve të reja për rajon për NUTS II. Në rastin kur do të dorëzohen më shumë se dy aplikime, përparësi do t'i jepen dy aplikimeve, të cilat përfshijnë më tepër lloje të kafshëve. Brenda të njëjtit numër kafshësh, renditet i pari ai që ka kapacitet më të lartë thërje. NUTS II janë të ndara sipas qarqeve të mëposhtme: Shqipëria e Veriut: Qarku Dibër, Durrës, Kukës, Lezhë dhe Shkodër; Shqipëria e Mesme: Qarku Elbasan dhe Tiranë; Shqipëria e Jugut: Qarku Berat, Fier, Gjirokastrë, Korçë dhe Vlorë.
47	A duhet të firmos kontratë me firmën, e cila do të kryejë ndërtimin?	Kontratat me ofruesit duhet të firmosen pas firmosjes së Kontratës së Grantit. Bëjnë përjashtim kontratat /faturat për shpenzimet e përgjithshme.